

VENDIM
Nr.891, datë 11.6.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA PËRPARIM, TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Përparim, të qarkut të Elbasanit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 9 (nëntë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Përparim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRASFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU

Komuna: **Përparim**

Nr.	Nr. i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK), shtrirja gjeografike EPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha.	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni me përgjegjësi administrativ e	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	64	EP Malsia Peqin	Mali Konaj	25	Pyll	52.70	Prodhues	M.M.P.A.U	Kom. Përparim	
2	65	EP Malsia Peqin	Shtëpia Kocufit	27	Pyll	37.00	Prodhues	M.M.P.A.U	Kom. Përparim	
3	66	EP Malsia Peqin	Prroi i Sopatit	28	Pyll	40.00	Prodhues	M.M.P.A.U	Kom. Përparim	
4	67	EP Malsia Peqin	Kodra e Sharrës	32a	Pyll	84.50	Prodhues	M.M.P.A.U	Kom. Përparim	
5	68	EP Malsia Peqin	Faqja e Proit	34	Pyll	12.00	Prodhues	M.M.P.A.U	Kom. Përparim	
6	69	EP Malsia Peqin	Përballë Konet	35	Pyll	71.60	Prodhues	M.M.P.A.U	Kom. Përparim	
7	70	EP Malsia Peqin	Faqja e Kishës	37	Pyll	67.20	Prodhues	M.M.P.A.U	Kom. Përparim	
8	71	EP Malsia Peqin	Ledhas	39	Pyll	97.00	Prodhues	M.M.P.A.U	Kom. Përparim	
9	73	EP Malsia Peqin	Kodra e Lames	44	Pyll	7.80	Mbrojtës	M.M.P.A.U	Kom. Përparim	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Përparim

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
64-71;73	Pyje, kullota, të tjera	Në pronësi